

SKEDË TEKNIKE

RÖFIX EPS-F 031

Pllakë termoizolimi për fasadë, gri



Fushat e përdorimit

Lambdapor është një material baze EPS special me aftësi të larta izolimi. Reflektor të rezeve infra të kuqe menjëherë përkthehen në nxehtësi të rezatimit I përshtatshëm për ndërtesa të vjetra dhe të reja. Të mos përdoret në zonën e xokolaturës dhe në zonat në kontakt me ujin. Në zonën e xokolaturës aplikohet pllaka izoluese e posaçme si (p.sh pllakat izoluese të xokolaturës RÖFIX EPS-P, EPS 035, etj).


Karakteristikat

- Vetë izoluese optimale
- Përpunim i shkëlqyer
- Pa HFCKW- dhe HFKW

Përpunimi



Të dhëna teknike

Numri i artikullit	2000150986	2000150934	2000150935	2000151676
EAN	9003304196050	9003304193493	9003304193509	9003304368495
Paketimi				
Sasi për njësi	5 m ² /Nj.	3 m ² /Nj.	2,5 m ² /Nj.	2 m ² /Nj.
Njësi për paletë	10 Copë/Nj.	6 Copë/Nj.	5 Copë/Nj.	4 Copë/Nj.
Gjatësia	1000 mm			
Gjerësia	500 mm			
Trashësia e izoluesit termik	50 mm	80 mm	100 mm	110 mm
Reaksioni ndaj zjarrit	E EN 13501-1			
Kapilariteti	< 0,05 kg/m ² *min0,5			
Difuzioni i avullit të ujit	rreth. 35			
Qëndrueshmëria ndaj tërheqjes tërthore	150 kPa			
Dendësia bruto	rreth. 15 kg/m ³			
Qëndrueshmëria ndaj prerjes	rreth. 0,05 kN/m ²			
Kapaciteti termik	rreth. 1,5 kJ/kg K			
Temperatura e nënshtresës	5-25 °C			

RÖFIX EPS-F 031

Pllakë termoizolimi për fasadë, gri

Numri i artikullit	2000150986	2000150934	2000150935	2000151676
Këshilla për paketimin	Paketuar në qese PE te riciklueshme			

Kushtet e punimit

Gjatë fazës së tharjes dhe përpunimit, temperatura e ambientit dhe bazamentit nuk duhet të bjerë nën +5 °C. Pllakat izoluese ruajini nw hije dhe shtrojini vetwm nw zona tw fasadws gjenden nen hije (rrjete ruajtese ne skela)

Bazamenti

Bazamenti duhet të jetë i pastër, i qëndrueshëm, i thatë, me aftësi mbajtëse, i lirë nga pluhurat, shpërthimet, elementët ndarës, koret dhe papastërtitë e çdo lloji. Bazamenti duhet të jetë konform normave kombëtare, me toleranca për bazamente muresh të pa përfunduar. Pjesa e jashtme e ndërtimit duhet të jetë e thatë dhe nuk duhet të krijojë lagështi në rritje (hidroizolim/ izolim horizontal). Bazamenti duhet të ketë një qëndrueshmëri lidhjeje prej min 0,25 N/mm².

Bazamenti-Trajtimi paraprak

Parregullsitë e mëdha të bazamentit nivelohen me një produkt të posaçëm. Ndërsa parregullsitë e vogla (<1cm) mund të kompensohen me një shtresë të llaçit ngjitës i cili aplikohet me metodën me pika dhe me shirita. Ashtu si kontrollohet suvaja për nga qëndrueshmëria dhe nga vrimat e mundshme, ashtu dhe veshjet ekzistuese duhet të kontrollohen për nga qëndrueshmëria. Suvaja dhe veshjet jo të qëndrueshme duhet të hiqen. Mbi bazament nëse është e nevojshme duhet të aplikohet astari i duhur, si dhe të verifikohet nga një ekspert përputhja e suvasë me llaçin ngjites. Largoni lëndët ndarëse që formojnë shtresa filmi (vaj armature etj.). Sipërfaqet prej karbonat kalciumi ose rërë përforcojini me RÖFIX fiksues ose largojini fare.

Këshilla për përpunimin

Shtrimi i pllakave termoizoluese duhet të jetë absolutisht i puthitur mirë. Kompesimi minimal i pllakes izoluese ashtu dhe madhesia e pjeseve te mbetura duhet të respektohen

sipas standardeve përkatëse specifike të vendit ose sipas shoqatave tregtare kombëtare. Sigurohet që nuk ka nyje kryq dhe as nyje të hapura ose bashkuese dhe që të mos ketë defekte ose parregullsi. Sigurohuni që as nyjet vertikale dhe as ato horizontale të panelit të mos takohen saktësisht në qoshet e derës ose në dritaret, madje edhe në rreshtin e parë të pllakave izoluese (mundësisht të krijoni një plan shtrimi). Në hapjet e ndërtesave pllaka duhet të përshtatet. Sheshoni pabarazitë me një bord gërryes ose prehës. Lidhjet me komponentët me koeficientë të ndryshëm të zgjerimit duhet të kryhen me profile lidhëse të përshtatshme si psh. shirit izolues për të bërë një izolim kundra ujit të materialit termoizolues. Pllakat me trashësi të mbi 20 cm, duhet të ngjiten në cepat e ndërtesave nga pjesa ballore me ngjitësin (psh. RÖFIX masë ngjitëse dhe izoluese Polymer). Vëndet problematike ose lidhje pllakash të hapura duhet të mbushen me material izolues. Fugat elastike të ndërtesës, duhet të integrohen në sistemin e termoizolimit me anë të profileve për fugat. Vetëm pas një kohe tharje të mjaftueshme (reth 36 orë) filloni me aplikimin mekanik të fasadës (zmerilim- ose vendosjen e tiplave).

Përpunimi

Ngjitja e pllakës termoizoluese: Llaçi ngjitës aplikohet me dorë ose me makineri me metoden me pika/shirita ose duke e përhapur ngjitësin me mistrinë e dhëmbëzuar. Për të siguruar një sipërfaqe me ngjitje sipas standartit (40% e sipërfaqes me ngjitës) duhet të aplikohet në të gjitha anët e pllakës një shirit i gjërë rreth 5cm dhe në qendër 3 pika me diameter rreth 15 cm. Sasia e shtresës së ngjitësit përshtatet sipas parregullsive të bazamentit.

Prerja mund të bëhet në mënyrë profesionale dhe të saktë duke përdorur prerësen e polisterolit (psh. Isoboy Tip C me tel të nxehtë).

Ju lutemi të zbatoni rregulloren e aplikimit të shoqatës kombëtare të ndërtimit dhe normat kombëtare aktuale (psh. DIN 55699 aplikimi i sistemit të termoizolimit, ose ÖNORM B6400-1 etj.). Nëse përdorni ngjyra të errëta me gradë reflektimi nga <25% HBW mbi sistemin e termoizolimit, duhet të keni parasysh rregulloren RÖFIX Syco- Tec. Për të zvogëluar efektin jastëk në sistemin e termoizolit me EPS, ne ju sugjerojmë për një trashësi pllake mbi 10 cm, të përdorni këto lloj pllakash termoizolimi për fasada: RÖFIX EPS-F 031 take-it ALPIN RELAX, EPS- F 031 take-it RELAX, EPS- F

ROFIX EPS-F 031

Pllakë termoizolimi për fasadë, gri

031 Compact RELAX ose EPS- F 031 RELAX.

Magazinimi

Magazinojeni në vënde të thata, nga lagështia dhe ndikimet UV (dielli, drita).

Koha e magazinimit min. 12 muaj.

Certifikatë



Udhëzime teknike dhe ligjore

Gjatë aplikimit të produkteve tona, respektoni të dhënat në skedat teknike, të cilat janë në përputhje me standardet e përgjithshme dhe specifike të vendit, si dhe të merren parasysh rekomandimet e shoqatës kombëtare të specialistëve.

Këshilla të përgjithshme

Kjo skedë teknike anullon dhe zëvendëson të gjitha versionet e mëparshme. Të dhënat e këtyre udhëzuesve teknike përkohë me njohuritë dhe përvojën tonë praktike të deritanishme. Ky informacion dhe të dhënat janë përpiluar me kujdes dhe me ndërgjegje të plotë, por pa mbajtur përgjegjësi për vendime ose veprime plotësuese që mund të marrë vetë konsumatori. Të dhënat në vetevete nuk provojnë asnjë lidhje ligjore ose detyrime të tjera anësore, dhe normalisht nuk e ndalojnë konsumatorin të testojë produktin për ato qëllime për të cilat edhe është prodhuar. Produktet ROFIX si dhe të gjitha materialet përbërëse, i nënshtrohen një kontrolli të vazhdueshëm, me anë të të cilit garantohej një cilësi e pandryshueshme. Stafit ynë është i gatshëm tju japë cdo ndihmë teknike në lidhje me përdorimin, përpunimin si dhe mund të ofrojë edhe trajnime praktike në lidhje me përdorimin e produkteve tona. Skedat tona teknike më të reja, me të dhënat aktuale, mund ti gjeni edhe në faqen tonë të internetit (www.roefix.com), ose mund të kërkohen edhe pranë filjaleve rajonale në vënd. Të gjitha të dhënat teknike të dhëna në këtë fletë produkti janë përcaktuar në kushte laboratorike.